



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-149, Rregulloren Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Drejtor në Departamentin e Kulturës

Institucioni: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Kategoria funksionale : Koeficienti: 10

Numri i referencës: 13/2018

I përgjigjet: Sekretarit të Përgjithshëm

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm , përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e poshtëshënuara:

1. Udhëheq dhe cakton objektivat e departamentit në përputhje me strategjinë dhe objektivat e institucionit dhe dizajnon planet vjetore të punës të detajuara për t'i përmbushur këto objektiva ;
2. Menaxhon stafin dhe buxhetin e departamentit dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar produkte dhe shërbime cilësore që janë relevante me funksionet e departamentit;
3. Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime/ përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit;
4. Zhvillon dhe mbikëqyre zbatimin e politikave dhe procedurave dhe ofrimin e shërbimeve në Departamentin e Kulturës;
5. Drejton funksionimin dhe administrimin e sistemit në Departamentin e Kulturës;
6. Ka përgjegjësi të gjëra dhe të shumëllojshme, përfshirë zhvillimin dhe mbajtjen e kontakteve të niveleve të larta me institucionet qeveritare dhe organizatat tjera;

7. Siguron ofrimin e shërbimeve të fushës së Kulturës dhe arkivimin e dokumenteve dhe shërbimeve tjera për ministrinë.
8. Bën vlerësim të rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e Kulturës;
2. Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktimit të objektivave dhe planifikim;
3. Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
4. Qasje fleksibile ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjedhjen e problemeve;
5. Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Diplomë universitare, Shkencat Shoqërore, Diplomë nga fusha e Kulturës, Artit, Muzikës.
7. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, përfshirë se paku 4 vite në pozitë drejtuese;
8. Vertetim nga Gjykata që nuk është nën hetime

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët .

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të pacaktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur pesëmbëdhjete (15) ditë.

Data e fundit e aplikimit është: 11.05.2018

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni mund të shkarkohet nga Web faqja e MKRS-se dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211 449 dhe 038 211 921 (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>).